



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

PROCESVERBAL

Tiranë, më 14.10.2018, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Fatjona Dhimitri – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

1. Diskutimi dhe votimi nën për nen i projektligjit “Për rininë” (*komision përgjegjës*).
2. Shpallja e 3 vendeve vakante në AMA.

Marrin pjesë:

Fatjona Dhimitri, Milva Ekonomi, Ramazan Gjuzi, Ismet Beqiraj, Fadil Nasufi, Almira Xhambulla, Bujar Çela, Lindita Nikolla, Klajdi Qama, Kostaq Papa, Selami Jenishehri, Amra Barova dhe Sadi Vorpsi (zëvendësues)

Mungojnë:

Fidel Ylli, Musa Ulqini, Vilma Bello, Adelina Rista, Mirela Kumbaro, Enada Kapllani.

Të ftuar:

Besa Shahini – Ministre e Arsimit, Sportit dhe Rinisë,
Erzen Tola – drejtor në Drejtorinë e Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë,
Ergisa Bebja – specialiste në Sektorin e Përgatitjes dhe Fizibilitetit të Projekteve Rinore.

HAPET MBLEDHJA

Fatjona Dhimitri – Përshëndetje!

Mirë se erdhët në mbledhjen e radhës së komisionit!

Sot në rendin e ditës, si pikë të parë kemi diskutimin dhe votimin nën për nen dhe në tërësi të projektligjit “Për rininë”. Komisioni ynë është komision përgjegjës. Relatore për këtë projektligj është zonja Almira Xhembulla.

Si pikë të dytë kemi shpalljen e 3 vendeve vakante në AMA, pas përfundimit të mandateve të zotërinjve: Gentian Sala, kryetar; Piro Misha, anëtar dhe Gledis Gjipali, anëtar.

Të ftuar për projektligjin janë: zonja Besa Shahini, ministre e Arsimit, Sportit dhe Rinisë; zoti Erzen Tola, drejtor në Drejtorinë e Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, si dhe zonja Ergisa Bebja, specialiste në Sektorin e Përgatitjes dhe Fizibilitetit të Projekteve Rinore.

Vijojmë me projektligjin “Për rininë”. Sikurse të gjithë e dime, në sesionin e kaluar parlamentar u vendos shtyrja për më vonë e diskutimit nën për nen dhe në tërësi të këtij projektligji, pasi ishim në pritje të raporteve të Komisionit të Ligjeve, të Komisionit të Integritetit, si dhe të Komisionit të Punës dhe Çështjeve Sociale.

Vazhdojmë me diskutimin nën për nen.

Neni 1.

Po, zonja Xhembulla.

Almira Xhembulla - Faleminderit, zonja kryetare!

Ashtu siç e thatë ju, ka pak kohë që ne e kemi kaluar këtë projektligj në parim dhe dhamë hapësirën, kohën e nevojshme, që veçanërisht Komisioni i Ligjeve të jepte mendimin e tij, duke qenë se shumica nga komentet, nga sugjerimet dhe nga dëgjuesat që bëmë me grupet e interesit lidheshin me formulime, që kryesisht kishin të bënin me teknikën legjislative. Më vjen mirë që një grup pune, i cili përbëhej nga përfaqësues të komisionit përgjegjës, Komisionit të Ligjeve, bashkë me përfaqësues të ministries, organizuan disa takime pune, me qëllim përfshirjen e këtyre komenteve, sugjerimeve dhe shqyrtimin në detaje, në thellësi të këtij projektligji.

Duke qenë se e kemi kaluar në parim, nuk po ndalem të rikujtoj edhe njëherë qëllimin, objektivat dhe rritjen e tij, duke menduar se tashmë i kemi ezauruar. Dua të them se ndryshimet kryesore që sugjerohen edhe nga komisionet e tjera, por edhe ato që kemi diskutuar, duhet të përfshijnë ndryshimet që kanë të bëjnë kryesisht me nenin 13, që lidhet

me kalimin e kësaj kompetence në drejtim të ngritjes së organizatave kombëtare të përfaqësuesve rinorë, si detyrim, si kompetencë me vendime të Këshillit të Ministrave, por do ta diskutojmë më në detaje në momentin e diskutimit nen për nen.

Nëse më lejoni, po filloj me rekomandimin që ka sjellë Komisioni i Ligjeve, që të shtohet një nen, duke qenë se në teknikën legislative njihet që projektligji fillon me “objektin” dhe “qëllimin” e tij. Sugjerimi është që të shtohet një nen në krye të këtij projektligji, që është objekti i ligjit: “Mbrojtja e të drejtave të të rinjve në mënyrë gjithëpërfshirëse, krijimi i kushteve të nevojshme për aktivizimin, pjesëmarrjen dhe mbështetjen e të rinjve, përcaktimi i funksioneve dhe kompetencave të institucioneve në nivel qendror dhe vendor, si dhe bashkëpunimi me organizatat që ushtrojnë veprimtarinë në fushën e rinisë”. Ky është një propozim që e kemi diskutuar dhe mendoj se do të ishte mirë të përfshihet në projektligj.

Fatjona Dhimitri – Të dëgjojmë përfaqësuesit e ministrisë, zonja Shahini?

Besa Shahini - Jemi dakord.

Fatjona Dhimitri - Kalojmë në votim. Kush është dakord me nenin 1? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Objekti i këtij ligji është “Mbrojtja e të drejtave të të rinjve në mënyrë gjithëpërfshirëse, krijimi i kushteve të nevojshme për aktivizimin, pjesëmarrjen dhe mbështetjen e të rinjve, përcaktimi i funksioneve dhe kompetencave të institucioneve në nivel qendror dhe vendor, si dhe bashkëpunimi me organizatat që ushtrojnë veprimtarinë në fushën e rinisë”.

Neni 2. Qëllimi

“Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i veprimtarive, mekanizmave dhe autoriteteve përgjegjëse për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të të rinjve në Republikën e Shqipërisë dhe të të rinjve shqiptarë në diasporë, si dhe financimi i veprimtarive rinore, në kuadër të së drejtës së të rinjve për mbrojtje të veçantë nga shteti”.

Mendimi i ministrisë?

Besa Shahini - Jemi dakord.

Fatjona Dhimitri – Në këtë nen mendoj të kemi edhe një shtesë, pas fjalës “diasporë” të shtohen fjalët “punën me rininë”. Po e lexoj edhe një herë nenin e riformuluar. “Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i veprimtarive, mekanizmave dhe autoriteteve përgjegjëse për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të të rinjve në Republikën e

Shqipërisë dhe të rinjve shqiptarë në diasporë, punën me rininë, si dhe financimin e veprimtarive rinore, në kuadër të së drejtës së rinjve për mbrojtje të veçantë nga shteti”.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Unë propozoj të jetë pjesë më vete. Ju, a mendoni se mund të përfshihet te qëllimi, të integrohet në këtë nen?

Besa Shahini - Dua të bëj një sqarim. Pas diskutimeve me Komisionin e Ligjeve, kanë sugjeruar që konceptin e “punonjësit rinor” të mos ta kemi në ligj për shkak se është shumë i parakohshëm. Ndërsa “puna rinore” ka mbetur si definicion për shkak se është një fushë, e cila duhet të zhvillohet dalëngadalë dhe është mirë të jetë në këtë ligj. Varet se cili është qëllimi i punës me rininë, nëse po e çojmë drejt punonjësit rinor, atëherë Komisioni i Ligjeve e ka kthyer si diçka që nuk është e pranueshme në këtë moment. Ndërsa nëse po flasim për punën rinore, atëherë jemi dakord. Vetëm duhet të dimë qëllimin e shtesës së togfjalëshit “punën me rininë”.

Fatjona Dhimitri - Unë propozova diçka. E hedhim në votim.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po, zoti Beqiraj.

Ismet Beqiraj – Unë e kam parë me shumë vëmendje projektligjin. Kjo ka të bëjë me teknikalitetin, me aspektin juridik dhe për të mos rënë në përsëritje.

Neni 1 i projektligjit është ndarë në dy nene: objekti dhe qëllimi. Kjo është shumë e saktë. Çdo shtesë tjetër është një apendiks i tepërt.

Fatjona Dhimitri – Hedhim në votim nenin 2. Kush është dakord?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po, pra, me propozimin e ministrit.

Miratohet!

Urdhëroni!

Ismet Beqiraj – Tani do të ndryshosh edhe emërtimin. Ai bëhet neni 2, ndërsa neni 2 bëhet neni 3.

Fatjona Dhimitri – Patjetër, po e theksoj që po kalojmë te neni 3.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po, neni 3: “Përkufizimet”.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Almira Xhambulla – Sipas rekomandimeve nga Komisioni i Ligjeve, duhet bërë një ndryshim sa i përket nenit 3, shkronja ‘c’. Sugjerohet të riformulohet me këtë përmbajtje: “Hapësira rinore e sigurt është çdo hapësirë ku ushtrojnë veprimtari të rinjtë e që plotësojnë

standardet e përcaktuara në legjislacionin për planifikimin dhe zhvillimin e territorit. Në rastin e të rinjve me aftësi të kufizuara, këto hapësira duhet të zbatojnë elementët e përshtatjes së arsyeshme, në përputhje me shkallën dhe llojin e aftësisë së kufizuar”.

Ky është rekomandimi në lidhje me shkronjën ‘c’.

Rekomandimi në lidhje me shkronjën ‘d’.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Prandaj po prisja, se thashë të vazhdojmë me ‘a’-në e me ‘b’-në.

Fatjona Dhimitri – Pika ‘c’ e nenit 3, i cili më parë ishte neni 2. E hedhim në votim.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Milva Ekonomi – A mund të them një gjë? Tani jemi te neni 3, nen i ri, i ripunuar. Aty kemi pikën ‘a’. A jeni dakord me formulimin e ‘a’-së?

Fatjona Dhimitri – Duke qenë se ajo kaloi direkt te pika ‘c’, menduam që të...

Milva Ekonomi – Po, pra, por nuk e kemi votuar ne.

Fatjona Dhimitri – Në rregull!

Milva Ekonomi – A jeni dakord me pikën ‘a’? Kush është dakord?

Fatjona Dhimitri – E lexojmë edhe një herë pikën ‘a’, te “Përkufizimet”, neni 3: “Në kuptim të këtij ligji, me termat e mëposhtëm nënkuptojmë: dialogu i strukturuar, dialogu i hapur, transparent, afatgjatë, i vazhdueshëm dhe sistematik nëpërmjet të rinjve e organizatave rinore, organizatave për të rinjtë, si dhe institucioneve në nivel qendror e vendor, që mbulojnë çështje të lidhura me të rinjtë.”

E hedhim në votim pikën ‘a’.

Milva Ekonomi – Dakord!

Fatjona Dhimitri – Dakord!

Pika ‘b’: “Edukimi joformal për të rinjtë”: “Çdo veprimtari e organizuar dhe e përshtatur për të rinjtë, jashtë sistemit formal të arsimit, i bazuar në nevojat dhe interesat e të rinjve, parimet e vullnetarizmit dhe pjesëmarrjes aktive të të rinjve në proceset e të nxënit, nëpërmjet të cilit fitojnë kompetencat e nevojshme për zhvillimin e potencialit personal, pjesëmarrjes aktive në shoqëri dhe aksesit në tregun e punës”.

E hedhim në votim pikën ‘b’ të nenit 3.

Po. Miratohet.

Milva Ekonomi – Pikën “c” e lexuam.

Fatjona Dhimitri – Po, pikën ‘c’, siç e lexuam, e hedhim në votim.

Milva Ekonomi – Dakord!

Fatjona Dhimitri – Miratohet!

Vazhdojmë me pikën ‘ç’ të nenit 3, “Infrastruktura rinore”: “Një hapësirë fizike, tokë, ndërtesë apo pjesë ndërtese, e projektuar dhe e planifikuar veçanërisht për të rinjtë dhe veprimtaritë rinore.”

E hedhim në votim.

Miratohet!

Pika ‘d’: “Politikë rinore”: “Veprimtaria e qëndrueshme, gjithëpërfshirëse, e ndërmarrë nga ana e pushtetit qendror e vendor, organizatave rinore dhe shoqërive që synojnë krijimin e kushteve të favorshme për zhvillimin personal të të rinjve dhe për pjesëmarrjen e tyre në jetën publike, sociale, ekonomike e kulturore në nivel vendor e kombëtar, nëpërmjet veprimtarive që inkurajojnë zhvillimin e të rinjve në vend.”

E hedhim në votim.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Almira Xhambulla – Në lidhje me pikën ‘d’ kemi një rekomandim të sugjeruar nga Komisioni i Ligjeve, që mendoj se është mirë ta reflektojmë, ku thuhet: “Sugjerohet heqja e shprehjes ‘organizatave rinore dhe shoqërive’”. Ky sugjerim bëhet pasi organet përgjegjëse për hartimin e politikave janë ministria përgjegjëse për fushën e Rinisë dhe njësitë vendore për kompetencat që ushtrohen prej tyre. Organizatat rinore të krijuara si OJF nuk janë hartuese politikash. Ato mbështesin institucionet përgjegjëse në realizimin e politikave të tyre.”

Fatjona Dhimitri – E hedhim në votë me ndryshimet e propozuara.

Dakord!

Miratohet!

Kalojmë në pikën ‘dh’.

Almira Xhambulla – Përsëri, në lidhje me pikën ‘dh’ kemi një sugjerim për ta reflektuar: “‘Punonjësi rinor’ i rekomandohet komisionit përgjegjës të rishikojë, duke vlerësuar heqjen e tij nga përmbajtja e këtij neni dhe e projektligjit në tërësi, pasi nuk e qartëson statusin e tij, dhe nëse mund të jetë punonjës rinor një person që nuk ka përfunduar arsimin e lartë, grupmoshat do të konsiderohen si punonjës rinorë e të tjerë.”

Fatjona Dhimitri – Përfaqësuesit e ministrisë. Po, urdhëroni!

Besa Shahini – Kjo ishte edhe ajo që përmenda pak më parë: punonjësi rinor i definuar, por jo i zbërthyer në këtë ligj ishte, si të themi, një koncept i parakohshëm për t’u përfshirë. Kësisoj, i rekomandoj Komisionit të Ligjeve që ta heqë, e më pas ne jemi plotësisht dakord.

Fatjona Dhimitri – Gjithashtu, kam edhe një lloj propozimi nga pala jonë, lidhur me termin: “punonjës rinor do të konsiderohet çdo person i punësuar në sektorin publik ose privat, që punon për dhe me të rinjtë, sipas parashikimeve të këtij ligji”. Si mendoni?

Besa Shahini – Ne mendojmë që, nëse e heqim fare, nuk kemi nevojë ta riformulojmë. Kësisoj, jemi dakord me heqjen e kësaj pike të këtij neni.

Fatjona Dhimitri – Atëherë e hedhim në votim pikën ‘dh’. Si mendoni?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

E hedhim në votim, po.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Atëherë, miratohet!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Në rregull, pra, e heqim.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Hedhim në votim heqjen e pikës ‘dh’.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po, urdhëroni!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Milva Ekonomi – Hedhim në votim heqjen e pikës ‘dh’.

Kush është dakord?

Miratohet!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po pra, ndërkohë ato rregullohen automatikisht. Ndërsa, ‘punonjës rinor’ që do të jetë në ligj edhe më tutje, do të jetë koncept i hequr tashmë. Ligji do të shkarkohet nga koncepti ‘punonjës rinor’.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

A mund ta përsëris pak, që të jemi të qartë? Pika ‘dh’ u hoq. Kur ligji të zbardhet përfundimisht, pika ‘e’ do të bëhet pika ‘dh’; bëhet automatikisht, sepse spostohet. Kësisoj, ne kemi hedhur poshtë pikën ‘dh’. Rregullimet e ligjit kanë për ta bërë ndryshimin në mënyrë automatike. Koncepti i punonjësit rinor, që është te pika ‘dh’, do të hiqet në të gjithë ligjin, sepse kemi hequr definicionin. Dakord jemi për këtë gjë?

Fatjona Dhimitri – Lidhur me propozimin e palës sonë, opozitës, kush është dakord me një riformulim të tillë?

E hedhim në votim?

Rrëzohet!

Vazhdojmë me pikën ‘e’: “Subjekti i politikave rinore”: “Çdo organ, institucion dhe strukturë në nivel qendror e vendor, që brenda fushës së vet të veprimtarisë ushtron përgjegjësi që prekin të rinjtë dhe harton politika rinore, si dhe aktorë të tjerë që marrin pjesë në procesin e hartimit e të zbatimit të politikave rinore .”

E hedhim në votim pikën ‘e’.

Milva Ekonomi – Dakord!

Fatjona Dhimitri – Miratohet!

Vazhdojmë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Almira Xhambulla – Edhe në lidhje me pikën ‘ë’ ka një sugjerim për t’u hequr, pasi parimi i (...) është një parim që rregullon funksionimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, dhe ky përkufizohet në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

Për këtë arsye, propozoj të hiqet.

Pika ‘e’ mbetet ashtu siç është, dhe e votuam. Jemi te pika ‘ë’.

Fatjona Dhimitri – E hedhim në votim pikën ‘ë’.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po, urdhëroni përfaqësuesit e ministrisë!

Besa Shahini – Ministria është dakord!

Fatjona Dhimitri – Hedhim në votim heqjen e pikës ‘ë’.

Miratohet!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Pika ‘f’: “të rinj”. “Persona që kanë mbushur moshën pesëmbëdhjetë vjeç, deri në moshën 29 vjeç”.

Nga ana e palës sonë, mendojmë të mos i identifikojmë si grup: “të rinj”, por si ‘i ri’, ‘e re’ dhe këtë e justifikojmë me faktin se kemi të bëjmë me të dhënat individuale të personit, kështu që nuk mund të përkufizojmë gjithë grupin pa iu referuar individit. Pra, mendojmë që ky lloj përkufizimi të shndërrohet nga ‘të rinj’ në ‘i ri’, ‘e re’, duke mos iu referuar gjithë grupit, por të dhënave individuale që ka çdo person në këtë grup.

Besa Shahini – Nuk kemi kundërshtim për këtë propozim. Mosha mbetet e njëjtë. Duhet të shohim vetëm mënyrën se si kjo zbërthehet në të gjithë ligjin, sepse gjithmonë i referohemi në shumës “të rinjtë”, por nuk jemi kundër propozimit.

(Diskutime pa mikrofon.)

Fatjona Dhimitri – “I re/e re, është personi që ka mbushur moshën 15 vjeç deri në 29 vjeç.”

Milva Ekonomi – Unë propozoj të jetë “të rinj” dhe vazhdon “i ri/e re që kanë mbushur moshën 15-29 vjeç”, pra heqim fjalën “persona” dhe e zëvendësojmë me “i ri/e re”.

Fatjona Dhimitri – Hedhim në votim shkronjë “f” me propozimin e bërë: “Të rinj, i ri/e re, personi që ka mbushur moshën 15-29 vjeç”.

Miratohet.

Lidhur me shkronjën “g”.

Almira Xhembulla – Në aspektin teknik, shkronjat “g” dhe “gj” sugjerohet të riformulohen me këtë përmbajtje: “Organizatat rinore janë persona juridikë jofitimprurës, të krijuar dhe të regjistruar në përputhje me legjislacionin në fuqi për organizatat jofitimprurëse, që kanë si objekt të veprimtarisë së tyre përfaqësimin, mbrojtjen dhe zhvillimin e interesave të të rinjve në mënyrë gjithpërfshirëse”. Kjo ishte për shkronjën “g”.

Fatjona Dhimitri – Ia japim fjalën përfaqësuesit të ministrisë.

Besa Shahini – Jemi dakord me përkufizimin e ri.

Fatjona Dhimitri – Hedhim në votim shkronjën “g”. Gjithmonë sipas propozimit të Komisionit të Ligjeve. Nuk i referohem ligjit të vjetër për këto propozime.

Miratohet.

Vazhdojmë me shkronjën “gj”.

Almira Xhembulla – Edhe për shkronjën ‘gj’: “Organizatat për të rinjtë janë persona juridikë jofitimprurës, të krijuar dhe të regjistruar në përputhje me legjislacionin në fuqi për OJF-të, që në fushën e veprimtarisë së tyre kanë për qëllim edhe mbrojtjen e zhvillimin e interesave të të rinjve dhe që kanë përvojë në zbatimin e programeve me ndikim për të rinjtë”.

Fatjona Dhimitri – Urdhëroni, përfaqësuesi i ministrisë!

Besa Shahini – Jemi dakord me propozimin e ri.

Fatjona Dhimitri – E hedhim në votim shkronjën “gj”.

Miratohet.

I drejtohem përfaqësuesit të ministrisë. Mendoj, nga ana e palës sonë, që sërish, te përkufizimet në këtë nen, të kemi edhe disa shtesa të tjera.

Mendojmë të kemi një shkronjë “i”: “Puna me rininë përfshin aktivitetet që organizohen për/me të rinjtë me karakter informues, edukues, ndërgjegjësues ose mobilizues, që mbështet zhvillimin ose fuqizimin personal dhe/ose social në përputhje me aftësitë dhe nevojat e tyre, ku të rinjtë marrin pjesë me dëshirën e tyre.”.

Mendojmë të ketë edhe një shkronjë tjetër: “Shërbimet rinore përfshijnë aktivitetet që kanë si qëllim mbështetjen emocionale, arsimore, këshillimin apo fuqizimin e të rinjve për të marrë pjesë dhe kontribuar në jetën shoqërore, ekonomike, kulturore dhe politike në vend”.

Një shkronjë tjetër: “Karta rinore është një shërbim kombëtar për të rinjtë, që jepet nga Shërbimi Kombëtar për Rininë në bashkëpunim me sektorët e rinisë në bashki dhe organizatat joqeveritare rinore”.

Përfaqësuesit e ministrisë a keni ndonjë koment për këto tri shkronja të propozuara nga ana e opozitës?

Besa Shahini – Faleminderit për propozimet tuaja!

Puna me rininë është shumë e ngjashme me punën rinore, që është e definuar në nenin 14 të ligjit, kështu që duhet vetëm të shohim nëse po bëjmë një dublifikim të panevojshëm.

Për shërbimet rinore, ndoshta na thotë Erzeni pak më shumë, se nuk jam e sigurt.

Për kartën rinore do të thosha që ne tashmë kemi filluar një proces të sigurimit të kartës për studentët, si në Tiranë, ashtu edhe për të gjithë studentët që janë jashtë Tiranës. Nuk e di se sa do të ishte e mundur ta realizojmë edhe përfshirjen e kartës rinore, duke pasur parasysh edhe obligimet që kemi marrë tani për kartën studentore. Kështu që besoj se do të na duhet pak më shumë kohë ta shohim edhe në aspektin financiar, por edhe në aspektin e impaktit që do të ketë për zhvillimin e të rinjve, pra grupit të njerëzve që kanë moshën 15-29 vjeç.

Fatjona Dhimitri – Unë mendoj se do të ishte një masë parandaluese për largimin e të rinjve, për arsye se kjo do të mbahet që nga gjimnazistët apo edhe nga të rinjtë e papunë deri në moshën 29 vjeç.

Erzen Tola – Lidhur me përkufizimin e shërbimeve rinore, në projektligj është trajtuar veprimtaria rinore, pra puna me të rinjtë dhe veprimtaria rinore, dhe nuk është në kontekstin e shërbimeve rinore.

Për këtë arsye mendojmë që nuk mund ta përfshijmë këtë përkufizim në ligj, se do të ndryshonte të gjithë kontekstin e projektligjit.

Fatjona Dhimitri – I hedhim në votim shkronjat e propozuara “i”, “j”, “k”.

Pro? Kundër? Abstenim?

Rrëzohen këto tri shkronja.

Vazhdojmë me nenin 3, i cili bëhet neni 4.

Almira Xhembulla – Me rekomandim të Komisionit të Ligjeve neni 3 sugjerohet të riformulohet me këtë përmbajtje:

“Parimet për mbështetjen e veprimtarisë së të rinjve”.

1. Mbështetja dhe fuqizimi i të rinjve bazohet në parimet e mëposhtme:
 - a. Parimin e barazisë dhe të mosdiskriminimit të sanksionuara nga Kushtetuta e RSH-së, aktet e tjera ndërkombëtare të ratifikuara nga RSH-ja dhe legjislacioni në fuqi.
 - b. Parimin e mundësive të barabarta dhe garantimit të pjesëmarrjes së të rinjve në proceset politikëbërëse dhe vendimmarrëse në fushat e arsimit, kërkimit shkencor, politikave financiare, mësimi, vullnetarizmit, mbrojtjes, përfshirjes sociale, shëndetësisë, kulturës, sportit, mjedisit, turizmit, drejtësisë, punëve të brendshme e të jashtme, integritetit dhe të mbrojtjes, teknologjisë së informacionit, sipërmarrjes dhe në fusha të tjera që inkurajojnë zhvillimin e të rinjve.
 - c. Parimin e lirisë së organizmit të iniciativave rinore dhe të vetëqeverisjes së organizatave.
 - ç. Parimin e solidaritetit.
2. Ky ligj garanton mbrojtjen e të rinjve, shtetas shqiptarë me vendbanim ose vendqendrim në territorin e RSH-së, si dhe të të rinjve shtetas të huaj ose persona pa shtetësi që kanë kërkuar mbrojtjen ndërkombëtare, sipas legjislacionit në fuqi, për azil në RSH, si dhe të shtetasve të huaj me qëndrim të rregullt për motive të ndryshme sipas legjislacionit në fuqi për të huajt”.

Fatjona Dhimitri – Urdhëroni, përfaqësuesit e ministrisë!

Besa Shahini – Jemi dakord me riformulimin.

Fatjona Dhimitri – Unë kisha edhe një sugjerim të neni 4, pika 1, paragrafi “b”, që pas “inkurajojnë zhvillimin e të rinjve”, të shtohet “dhe shërbimeve”.

Besa Shahini – Duke marrë parasysh që nuk u përfshi të përkufizimet, nuk di nëse vlen të shtohet këtu.

Fatjona Dhimitri – Si e mendon përfaqësuesi ligjor?

Erzen Tola – Ky togfjalësh do të ndryshonte gjithë konceptin e ligjit, sepse ne në ligj shërbimet i kemi përkufizuar dhe përfshirë të veprimtaria rinore dhe të puna rinore.

Fatjona Dhimitri – Hedhim në votim nenin 4; nëse nuk e them, kuptohet se gjithmonë është marrë parasysh vlerësimi i Komisionit të Ligjeve.

Miratohet.

Almira Xhembulla – Para se të kalojmë te neni 4, sugjerohet që titulli i kreut të dytë të projektligjit të ndryshohet nga “Rrjeti rinor” në “Organizmi institucional”.

Fatjona Dhimitri – Përfaqësuesi i ministrisë.

Besa Shahini – Jemi dakord.

Fatjona Dhimitri – Sërish po bëj një propozim: në qoftë se kreun II e quajmë më tepër se sa organizim institucional, mekanizmat institucionalë për rininë...

(Diskutime pa mikrofon.)

E përcakton ministria këtë gjë.

Duhet të mendojmë jo për interesat tona, por për interesat e rinisë.

Urdhëroni!

Erzen Tola – Lidhur me përkufizimin e paraqitur si titull të këtij kreu, mendoj se në këtë kre nuk përfshihen mekanizma, por janë institucione të cilat do të trajtojnë çështjet e rinisë dhe do të punojnë me rininë. Për këtë shkak, Komisioni i Ligjeve e riorganizoi jo si rrejt rinor, por si organizim institucional.

Për këtë arsye, gjykoj që fjala “mekanizëm” nuk shkon në këtë kre.

Fatjona Dhimitri - E hedhim në votim propozimin e Komisionit të Ligjeve.

Miratohet.

Neni 4. “Rrjeti rinor”.

Almira Xhembulla – Duke qenë se u diskutua për terminologjinë e rrjetit rinor, mendoj, siç sugjerohet nga komisioni përgjegjës, të shikojmë mundësinë e riformulimit ose heqjen e tij, pasi përmbajtja e këtij neni nuk është e qartë dhe është e trajtuar më poshtë në dispozitat e tjera të projektligjit, unë sugjeroj që të hiqet nga projektligji.

Fatjona Dhimitri – Përfaqësuesi i ministrisë.

Besa Shahini – Jemi plotësisht dakord. Koncepti i rrjetit rinor është një koncept, që duhet të zhvillohet nga vetë organizatat joqeveritare dhe jo të përkufizohet në ligj domosdoshmërisht, kështu që e kanë lirinë e plotë që të organizojnë sa të duan rrjete rinore, që të përfaqësojnë sa më mirë interesat e tyre.

Fatjona Dhimitri – E hedhim në votim.

Miratohet.

Neni 5.

Almira Xhembulla – Në nenin 5, në shkronjën “a”, pas fjalës “politikat”, sugjerohet të shtohet togfjalëshi “programet dhe strategjitë”.

Shkronja “d” riformulohet me këtë përmbajtje: “monitoron standardet për ndërtimin e hapësirave rinore, të sigurta dhe të aksesueshme për të rinjtë”.

Pas shkronjës “h”, sugjerohet të shtohen shkronjat “f”, “g” dhe “gj” me këtë përmbajtje:

“f. harton dhe propozon bazën ligjore në fushën e rinisë dhe të shërbimeve për të rinjtë;

g. siguron ofrimin e shërbimeve për të rinjtë në bashkëpunim me institucionet e tjera qendrore, njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe me autoritetet e tjera, duke përcaktuar standardet në ofrimin e shërbimeve rinore dhe punës me rininë;

gj. siguron zhvillimin e konsultimeve me të rinjtë, lidhur me politikat dhe programet rinore në vend, si dhe programet e shkëmbimit rinor ndërkombëtar.”

Fatjona Dhimitri – E hedhim në votim.

Përfaqësuesi i ministrisë.

Besa Shahini – Shkronja “f” mendoj se është një përsëritje. Ne mund ta përfshijmë te shkronja “a”, nëse propozon politika të programeve dhe strategjive, për të cilat jemi dakord. Thjesht të përfshihet edhe baza ligjore, që të mos ketë nevojë të jetë një shkronjë e veçantë.

Sa i takon shkronjës “g”, se e diskutuam ofrimin e shërbimeve për të rinjtë, sugjeroj të hiqet, për shkak se nuk jemi duke diskutuar konceptin e shërbimeve për të rinjtë, por veprimtaritë e të rinjve dhe për të rinjtë.

Jemi dakord me shkronjën “gj”, mirëpo më duket pak përsëritje e diçkaje që ndodh, ashtu se ashtu.

Ne vazhdimisht bëjmë konsultime me të rinjtë. Ky ligj na obligon edhe më shumë për të ardhmen. Kjo mund të qëndrojë, por edhe mund të hiqet, se është thjesht vendimi juaj.

(Diskutime pa mikrofon.)

Almira Xhembulla – Atëherë, kalojmë shkronjë “f”, që e shtojmë te shkronja “a”, ndërkohë për shkronjën “gj”, mendoj ta heqim.

Fatjona Dhimitri – Nuk mendoj se duhet të hiqet shkronja “g”: “Siguron ofrimin e shërbimeve për të rinjtë në bashkëpunim me institucionet e tjera qendrore, njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe me autoritetet e tjera, duke përcaktuar standardet në ofrimin e shërbimeve rinore dhe punës me rininë”.

(Diskutime pa mikrofon.)

Si mendoni për shkronjën “g”?

Unë mendoj se kemi një koordinim institucionesh qendrore dhe vendore.

Milva Ekonomi - Shkronja “a” bëhet: “hartohen dhe propozohen ligje, politika, programe dhe strategji për veprimtaritë për rininë”. Kështu do të bëhet?

Fatjona Dhimitri – Shkronja “f” kalon lart dhe i shtohet shkronjës “a”.

(Diskutime pa mikrofon.)

Erzen Tola – Jam dakord me zonjën Ekonomi, sepse kjo ishte edhe logjika e asaj që tha zonja ministre dhe relatorja.

Për shkronjën “g” nuk ka akoma një qëndrim.

Fatjona Dhimitri – Hedhim në votim shkronjën “g”, nëse do ta heqim apo jo.

E heqim. Miratohet.

Erzen Tola – Në vijim të asaj që theksoi edhe ministrja, sqaroj se ka një kuadër të tërë ligjor lidhur me konsultimin publik të projektakteve, strategjive dhe akteve të rëndësishme, siç përcaktohet edhe në projektligj, prandaj e mendojmë të tepërt që të kemi edhe një përcaktim shtesë lidhur me konsultimin publik të politikave rinore.

Fatjona Dhimitri – Hedhin në votim nëse do e mbajmë apo jo shkronjën “gj”.

Miratohet të hiqet.

Votojmë nenin 5 me ndryshimet e propozuara.

Miratohet.

Neni 6, “Institucionet e tjera qendrore”.

Urdhëroni!

Ismet Beqiraj – Komisioni ka bërë disa propozime. Te shkronja “a” e nenit 6 bëhen këto ndryshime:

Të hiqet përcaktimi “të drejtat e ...” dhe të mbetet “të hartojnë politika sektoriale, akte ligjore e nënligjore të nevojshme për të rinjtë, si dhe të kontribuojnë në hartimin e politikave dhe programeve ndërsektorale, duke siguruar edhe marrjen e mendimit të të rinjve”.

Fatjona Dhimitri – Si mendon ministria?

Në rregull, e hedhim në votim shkronjën “a” të nenit 6.

Ismet Beqiraj – Gjithashtu, të hiqet përcaktimi “marrjen e mendimit të të rinjve” dhe të zëvendësohet me përcaktimin “përfshirjen dhe pjesëmarrjen e të rinjve dhe organizmave të rrjetit rinor.”.

Fatjona Dhimitri – Unë nuk jam e mendimit që të hiqet, se këtu kemi gjithëpërfshirje. Është gjithëpërfshirja.

Ismet Beqiraj – Po të themi “rrjeti rinor”, ne e kemi hequr si fjalë...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fatjona Dhimitri - Shkronja “b”, “Të parashikojmë në planet vjetore apo shumëvjeçare buxhetore fondet e nevojshme për përmbushjen progresive të të drejtave të të rinjve”. Nuk ka ndryshim.

“Të bashkëpunojnë me institucionet përkatëse për të siguruar mbrojtjen e të drejtave të të rinjve”. Nuk ka ndryshim.

Hedhim në votim nenin 6.

Miratohet.

Përpara se të kalojmë te neni 7, unë propozoj për një shtim neni: “Mekanizmat institucionalë për rininë”, që në fakt duhet të ishte trajtuar përpara se të kalonim tek institucionet qendrore, por...

“Mekanizmat institucionalë për rininë shtrihen në nivel qendror dhe vendor. Mekanizmat këshillimorë dhe koordinues institucionalë janë: Këshilli Kombëtar i Rinisë në nivel qendror dhe Këshilli Vendor i Rinisë.”

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Strukturat për rininë në nivel qendror janë: ministri përgjegjës që bashkërendon punën për çështjet e Rinisë, Koordinatori Kombëtar për Rininë; Shërbimi Kombëtar për rininë, çdo ministër përgjegjës, sipas fushës që mbulon, ndër të tjera çështjet e të rinjve; strukturat për rininë në nivel vendor janë: bashkia, sektori për rininë në bashki. Të gjitha mekanizmat dhe strukturat shtetërore në nivel qendror dhe vendor bashkëpunojnë dhe koordinojnë punën ndërmjet tyre për zbatimin e legjislacionit dhe politikave shtetërore për rininë. Mekanizmat dhe strukturat bashkëpunojnë me organizatat jofitimprurëse rinore dhe grupime rinore, studentore e të tjerë për realizimin e politikave kombëtare vendore për rininë, si dhe për ofrimin e shërbimeve në zbatim të këtij ligji. Përpara se të kalojmë te hallkat e institucioneve, këtë mund ta trajtojmë edhe si nen më vete.

Erzen Tola– Çështjen e mekanizmave e diskutuam që në titullin e kreut II. Mendoj se edhe formulimi nuk është shumë korrekt, sepse mekanizmat nuk janë këshillat, këshillat janë organe dhe, për pasojë, të gjitha këto struktura që janë parashikuar këtu, me përjashtim të koordinatorit kombëtar, janë të trajtuara në projektligj, janë pjesë e tij dhe janë të organizuara dhe të diskutuara me grupet e interesit, me institucionet e tjera, me ministritë e linjës dhe me komisionin përkatës. Kështu që konsideroj se ky formulim dhe ky lloj organizimi në mekanizma dhe struktura janë të tepërta.

Fatjona Dhimitiri- E hedhim në votim propozimin.

Kush është dakord?

Propozimi rrëzohet.

Vazhdojmë me nenin 7 “Njësitë e vetëqeverisjes vendore”.

A ka ndryshim nga Komisioni i Ligjeve, sipas raportit?

Almira Xhembulla- Unë mendoj ta kalojmë pikën 1, sepse sugjerimet janë pas pikës 2, ku sugjerohet të shtohet pika 2/1 me këtë përmbajtje: “Për zbatimin e detyrimeve të parashikuara në këtë nen, njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të bashkëpunojnë me njëra-tjetrën nëpërmjet lidhjes së marrëveshjeve të përbashkëta, në përputhje me legjislacionin në fuqi për vetëqeverisjen vendore”. Ky është i vetmi sugjerim për ndryshim në nenin 7.

Fatjona Dhimitri- A kanë diçka për të shtuar përfaqësuesit e ministrisë lidhur me pikën 3 të nenit 7?

Erzen Tola – Ne jemi dakord parimisht me shtimin e kësaj pike, me pikën 2/1, por dua t’ju informoj se edhe Komisioni i Ligjeve ka qenë i dyzuar, sepse në ligjin për vetëqeverisjen vendore kjo mundësi bashkëpunimi ndërmjet njësive vendore është e parashikuar shprehimisht në ligj. Ata menduan ta shtonin edhe në këtë ligj dhe ne, parimisht, jemi dakord, por mbetet në vlerësimin tuaj.

Fatjona Dhimitri- E hedhim në votim propozimin për një shtesë të pikës 2/1. Kush është dakord?

Miratohet.

Lidhur me njësitë e vetëqeverisjes vendore, në nenin 7, pika 1, unë kam një propozim. Propozoj të riformulohet me këtë përmbajtje:

“Njësitë e vetëqeverisjes vendore, në përputhje me funksionet e tyre, hartojnë dhe zbatojnë politikat vendore në fushën e rinisë, si dhe janë përgjegjëse për ngritjen e sektorit të rinisë në bashki.

Spektori është pjesë e strukturës organike të bashkisë dhe mbështetet në ushtrimin e funksioneve dhe realizimin e detyrave nga stafi dhe fondet e bashkisë; caktimin e të paktën një personi përgjegjës në bashki për çështjet e të rinjve; krijimin e programit buxhetor për rininë në buxhetin e bashkisë për rininë, në bashkëpunim me këshillin bashkiak, këshillin vendor rinor dhe organizatat e të rinjve në territor; zhvillimin e programeve dhe nismave të përbashkëta në konsultim me këshillin rinor vendor dhe organizatat e të rinjve; mbledhjen, analizimin dhe raportimin e të dhënave statistikore në bashkëpunim me institucionet e tjera vendore për situatën e të rinjve dhe të rejave në territor dhe ndarjen e këtyre me koordinatorin kombëtar për rininë; mbledhjen, analizimin dhe bërjen publike të të dhënave të raporteve statistikore, të raporteve të tjera për rininë dhe koordinon me ministrat e tjerë me qëllim përshtatjen e politikave të rinisë”.

Çfarë mendimi kanë përfaqësuesit e ministrisë për këtë propozim? Besoj se janë të paraqitura këto pika.

Besa Shahini- E kemi pak të vështirë t’i përcjellim, pasi nuk i kemi përpara. Unë dua të them vetëm diçka të përgjithshme. Çështjet rinore, njësoj si çështjet e grave, janë çështje ndërsektoriale. Nuk e di nëse është e domosdoshme që brenda bashkive të ketë një person që punon për çështjet rinore, kur, në fakt, duhej që bashkitë të mendojnë për nxitjen e vullnetarizmit, përfaqësimit të interesave rinore në mënyrën më të mirë të mundshme, politikat e bashkive dhe kanë gjithsesi edhe këshillin vendor rinor, i cili jo vetëm sugjeron për

mënyrën se si ato mund të marrin vendime për politika rinore, por edhe i monitoron bashkitë nëse ato i realizojnë premtimet që kanë bërë në këtë fushë. Kështu që nuk jam e sigurt nëse do të duhet të përfshihej një strukturim, siç lexuat ju deri tani, i cili disa pika i ka të përfshira në ligjin që keni përpara, ndërsa për pjesën tjetër nuk e di nëse është e domosdoshme.

Fatjona Dhimitri -Lidhur me disa nene, për të cilat edhe unë ju bëj propozimin, në qoftë se ministria kërkon kohën e nevojshme për t'i shqyrtuar, nëse mund të kemi një amendim, atëherë mund të merrni kohën e nevojshme, përpara se ta kalojmë në votim në tërësi nenin.

Milva Ekonomi – Për procedurë.

Zonja kryetare, në fakt, ky lloj diskutimi që bëhet këtu është pak i vonuar, sepse përpara se t'i çoheshin ministrisë amendimet që ju kishit, duhet t'i kishim ne, anëtarët e komisionit, që nuk i kemi, sepse u sollën në këtë moment. Përveç kësaj, është një diskutim në procedurë, nuk mund të vendosim tani se çfarë mund të bëjmë, pasi amendimet e dhëna duhet t'i kishim më parë. Po t'i shohim me kujdes ato që lexuat ju, gati të gjitha pikat janë të përfshira këtu dhe ka nevojë vetëm për riformulim, asnjë ndryshim tjetër.

Fatjona Dhimitri- Unë mendoj se nuk kemi pse të nxitohemi dhe ta kalojmë sot në tërësi. Në qoftë se ka nene të projektligjit, të cilat kanë një lloj dyshimi lidhur me votimin e tyre deri në hapat finalë, atëherë mendojmë ta shqyrtojmë edhe një herë nenin.

Milva Ekonomi- Ky nuk ka ndryshime thelbësore, që duhet të na marrë kohë për t'i parë. Ky nen ka ndryshime në formulim, prandaj mendoj ose të shohim formulimin tuaj, ose atë që ka ardhur, por, automatikisht, formulimi juaj, i cili ka ardhur me vonesë, bie poshtë, sepse nuk ka pasur kohë të diskutohet.

Fatjona Dhimitri - Atëherë, hedhim në votimi propozimin e Komisionit të Ligjeve për shtim neni 2/1. Kush është dakord?

Besa Shahini- Ne jemi dakord me propozimin e Komisionit të Ligjeve.

Fatjona Dhimitri- Dakord.

Miratohet.

Hedhim në votim propozimin që bëra unë.

Propozimi rrëzohet.

Hedhim në votim në tërësi nenin 7.

Miratohet.

Kalojmë te neni 8.

Almira Xhembulla – Në nenin 8 kemi një sugjerim për shkronjën “b”: pas fjalës “monitoron” të shtohet fjala “mbikëqyr”. Shkronja “dh” sugjerohet të ndryshohet me

përmbajtjen si më poshtë: “Siguron financime nëpërmjet aplikimit në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare, të cilat transferohen mbi bazë vjetore në rastet kur miratohet një projekt shumëvjeçar”.

Pas shkronjës “dh”, sugjerohet të shtohen shkronjat dh/1, dh/2 dhe dh/3, si më poshtë: dh/1. “Mbledh, administron dhe analizon të dhënat mbi situatën e të rinjve në bashkëpunim me institucionet e tjera dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore”; dh/2 “Raporton në mënyrë periodike pranë ministrisë përgjegjëse për rininë, për situatën e të rinjve dhe zbatimin e detyrimeve që burojnë nga ky ligj”; dh/3. “Mbikëqyr ofrimin e shërbimeve rinore dhe të punës me të rinjtë nga organizatat rinore dhe organizatat për të rinjtë, që përfitojnë mbështetje sipas parashikimeve të këtij ligji”.

Fatjona Dhimitri- Ju lutem, përfaqësuesit e ministrisë!

Besa Shahini – Ne jemi plotësisht dakord. Kjo e fuqizon shumë më shumë institucionin përgjegjës për rininë dhe duhet t’i ketë të gjitha këto funksione. Unë dua t’i tërheq vëmendjen komisionit lidhur me fjalët “shërbimet rinore”, për shkak se i hoqëm në një moment nga definimet dhe ndoshta edhe këtu duhet të pasqyrohen veprimtaritë dhe jo shërbimet, ashtu siç bëmë me nenet e tjera.

Almira Xhembulla- Në momentin që ne do ta bëjmë projektligjin e integruar me të gjitha komentet dhe të votuar, duhet që t’i reflektojmë të gjitha ndryshimet, sidomos ato që lidhen me përkufizimet, të cilat i ndryshuam apo i hoqëm.

Fatjona Dhimitri – Përsëri dua t’u drejtohem përfaqësuesve të ministrisë. Lidhur me institucionin përgjegjës për rininë, mendojmë që të kemi këtë formulim: “Shërbimi kombëtar për rininë është personi juridik në varësi të ministrisë përgjegjëse për çështjet e rinisë dhe financohet nga buxheti i shtetit; shërbimi luan rolin e sekretariatit teknik të Këshillit Kombëtar të Rinisë dhe mbështet, ndër të tjera, edhe koordinatorin kombëtar për rininë; shërbimi drejtohet dhe përfaqësohet nga kryetari, marrëdhëniet e punës të të cilit rregullohen sipas legjislacionit për nëpunësin civil; kryetari duhet të ketë të paktën 5 vjet eksperiencë pune në pozicione drejtuese, në institucione publike ose organizata rinore; kryetari zgjidhet nga ministri përgjegjës për çështjet rinore; struktura dhe organika e shërbimit miratohen nga Këshilli i Ministrave me propozimin e ministrit përgjegjës për çështjet e rinisë, brenda tre muajve nga hyrja në fuqi e ligjit; rregullat e organizimit dhe të funksionimit të shërbimit kombëtar të rinisë përcaktohen në rregulloren e shërbimit, e cila miratohet nga ministri përgjegjës për çështjet e rinisë brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e ligjit”.

Shërbimin Kombëtar të Rinisë e kemi aktiv, por, në qoftë se kemi një formulim të tillë: “është person juridik, publik dhe buxhetor”, duket sikur ne ia heqim kompetencat Shërbimit Kombëtar të Rinisë. Çfarë mendoni lidhur me këtë formulim?

Besa Shahini - Kjo që ju propozoni përfshin edhe termin “Shërbim Kombëtar Rinor” edhe “koordinatorin kombëtar”, të cilët nuk janë më. Ideja ishte që institucioni përgjegjës për rininë nuk ka nevojë të quhet më Shërbimi Kombëtar Rinor, por të quhet diçka që është më e përshtatshme dhe për këtë do të diskutohet. Në vendimin e Këshillit të Ministrave vendosen edhe parimet, mbi të cilën kjo do të funksionojë, si edhe të gjitha këto që ju përmendet, si kriteret që do t’i përmbushë kryetari apo edhe mënyrën e funksionimit. Unë mendoj se institucionit përgjegjës për rininë nuk po i hiqen funksionet e SHKR-së, përkundrazi, po i shtohen funksione që kanë të bëjnë me financimin e organizatave, mbikëqyrjen e tyre dhe me sigurimin që këto organizata janë me të vërtetë të shëndetshme, rriten në mënyrë progresive dhe kontribuojnë në zhvillimin e përgjithshëm jo vetëm të të rinjve, por edhe të demokracisë në vend. Kështu që unë mendoj se me propozimin që kemi bërë, ne po i shtojmë funksione dhe po i rrisim rolin kësaj organizate. Natyrisht që duhet një riorganizim total i kësaj që sot është SHKR, që të themelohet institucioni i ri që parashikohet me këtë ligj.

Fatjona Dhimitri- Por sërisht mbetet një institucion fantazmë. Është person juridik, publik, buxhetor, kur ndërkohë ne e kemi një shërbim të tillë.

Besa Shahini- SHKR-ja hiqet nga funksioni dhe rithemelohet institucioni i ri, duke marrë elementet më të mira të SHKR-së dhe parimet që janë përcaktuar te ky nen.

Fatjona Dhimitri – Hedhim në votim gjerat “dh”, “dh 1”, “dh 2” dhe “dh 3” të nenit 8.

Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

E hedhim nenin 8 në votim në tërësi lidhur me propozimin e bërë nga unë për Shërbimin Kombëtar për Rininë.

Kush është dakord?

Rrëzohet.

Kalojmë te neni 9.

Almira Xhembulla – Neni 9 sugjerohet të riformulohet si më poshtë:

“Këshilli Kombëtar i Rinisë është organ këshillimor, që funksionon pranë ministrit përgjegjës për rininë. Këshilli ushtron kompetencat e mëposhtme:

a) i paraqet ministrit përgjegjës për rininë politikën prioritare, buxhetin dhe veprimtarinë në fushën e rinisë;

- b) propozon drejtimet dhe programet kryesore për mbështetjen, fuqizimin dhe pjesëmarrjen e të rinjve;
- c) jep mendim për hartimin e Strategjisë Kombëtare për Rininë dhe monitoron zbatimin e saj;
- d) miraton raportin vjetor për zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Rininë dhe situatën e të rinjve.”

Ndërsa për pikën 2 të këtij neni propozohet që Këshilli Kombëtar i Rinisë të kryesohet nga ministri përgjegjës për rininë dhe ka në përbërje 14-16 anëtarë, ku të paktën gjysma e anëtarëve përfaqësojnë organizata rinore dhe/ose për të rinjtë. Anëtarët e Këshillit Kombëtar të Rinisë të emërohen me urdhër të ministrit përgjegjës për rininë.

Pika 3. “Kriteret dhe procedurat e zgjedhjes së anëtarëve, si dhe mënyra e organizimit dhe funksionimit të Këshillit Kombëtar të Rinisë të miratohen me VKM”.

Fatjona Dhimitri – Po, përfaqësuesi i ministrisë lidhur me propozimet e Komisionit të Ligjeve.

Besa Shahini – Jemi dakord me këto propozime. Ne kemi eksperiencë me këshillat kombëtarë të tjerë që rregullojnë çështje të ndryshme të arsimit parauniversitar, apo dhe të tjera, kështu që do t’i përcjellim me të njëjtën frymë edhe në zbatimin e kësaj pike të ligjit.

Fatjona Dhimitri – Edhe unë kam një propozim para se ta hedhim në votim.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po, urdhëroni!

Ismet Beqiraj – Ai është riformuluar dhe propozimi ka kaluar nga pika 2 në pikën 3. Komisioni i Punës propozon që të hiqet përcaktimi për Këshillin Kombëtar të Rinisë, thjesht ku thuhet “kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Vendor të Rinisë, si dhe mënyra e organizimit dhe funksionimit të Këshillit Vendor të Rinisë miratohen me vendim të Këshillit Bashkiak, duke iu referuar, për aq sa është e mundur kriterëve dhe procedurave të miratuara nga KM”, të hiqet “për Këshillin Kombëtar të Rinisë”, të cilën e ka propozuar edhe Komisioni i Punës.

Unë jam plotësisht dakord.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fatjona Dhimitri – Nuk jemi tek institucionet vendore.

“Këshilli Kombëtar i Rinisë kryesohet nga ministri përgjegjës për rininë dhe ka në përbërjen e tij 14-16 anëtarë, ku të paktën gjysma e anëtarëve përfaqësojnë organizatat dhe/ose për të rinjtë. Anëtarët e Këshillit Kombëtar të Rinisë emërohen me urdhër të ministrit përgjegjës”, i bie që të jetë në varësi të ministrisë, pra që anëtarët e Këshillit Kombëtar të

Rinisë të kalojnë si një institucion në varësi të ministres, pra si një institucion politik, ku nuk ka asnjë zë kundër.

Milva Ekonomi – Kur gjysma e anëtarëve emërohen nga përfaqësuesit, domethënë ata sjellin propozimin dhe kur organizatat rinore thonë një emër, ministri nxjerr menjëherë një urdhër.

Fatjona Dhimitri – Ministri nuk mund të emërojë përfaqësuesit e shoqërisë civile.

Milva Ekonomi – E bën me urdhër për t'i dhënë statusin.

Besa Shahini – A mund të jap një shpjegim të shkurtër?

Fatjona Dhimitri – Po.

Besa Shahini – Këshilli Kombëtar i Rinisë ka si qëllim të këshillojë ministrin për çështjet e rinisë, prandaj duhet të jetë pranë ministrisë, duhet të kryesohet nga ministri, duhet të ketë përfaqësues nga të gjitha institucionet përgjegjëse për sigurimin e çuarjes përpara të interesave dhe të drejtave rinore, si Ministria e Financave dhe do të ketë përfaqësimin e duhur të barabartë me anëtarët e tjerë të organizatave të shoqërisë civile. Për kriteret se si zgjidhen përfaqësuesit e organizatave të shoqërisë civile, merret një vendim i dytë, por nga mënyra si kemi punuar deri tani zakonisht ose bëhet me konkurs aty ku kemi nevojë të kemi përfaqësues të organizatave të tjera, ose institucionet e ndryshme, pasi u kërkojmë të caktojnë një përfaqësues, e dërgojnë atë pranë ministrisë.

Urdhri i ministrit thjesht e legjitimon emrin që ka ardhur i propozuar nga organizatat. Kështu që nuk do të ketë këtu ndonjë përcaktim nga ana e ministrisë se kush do të jetë përfaqësues aty. Thjesht vendoset një rregull, sipas të cilit vijnë përfaqësuesit dhe japin kontributin e tyre, duke përfaqësuar organizatat e tyre, domethënë që i kanë zgjedhur ata persona për të qenë pranë Këshillit.

Fatjona Dhimitri – Lidhur me pikën 2, përpara se ta hedhim sërish në votim, kam një propozim: “...përfaqësuesit e shoqërisë civile, përbërës në këshill, zgjidhen me votim të fshehtë dhe konkurrues nga Këshilli Kombëtar i Shoqërisë Civile, sipas rregullave të përcaktuara prej tij. Përfaqësuesit nga shoqëria civile duhet të jenë shtetas shqiptarë me veprimtari të shquar dhe të verifikueshme për të drejtat e të rinjve dhe të rinjtë”

Besa Shahini – Këshilli Kombëtar i Shoqërisë Civile nuk ekziston, kështu që është pak vështirë, nëse i referohemi diçkaje që mund të pengojë realizimin e detyrave që ka ky Këshill.

Fatjona Dhimitri – Atëherë, derisa ju të merrni një informacion, i qëndroni bindjes suaj?

Në rregull.

Lidhur me pikën 2 të nenit 9, hedhim në votim propozimin e Komisionit të Ligjeve.

Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Hedhim në votim propozimin e bërë nga pala e opozitës.

Kush është dakord?

Rrëzohet.

Pika 3. “Kriteret dhe procedurat e zgjedhjes së anëtarëve, si dhe mënyra e organizimit dhe funksionimit të Këshillit Kombëtar të Rinisë miratohen me VKM.”.

Besa Shahini – Çfarëdo propozimi që kemi, për të bërë sa më transparent dhe demokratik procesin e përzgjedhjes së anëtarëve, do ta marrim parasysh në momentin kur të fillojmë hartimin e kësaj VKM-je, kështu që janë të mirëseardhura të gjitha këto propozime që u bënë. Është shumë mirë që i kemi edhe me shkrim të hartimi i VKM-së.

Fatjona Dhimitri – Në fakt, ky nen duket sikur Këshillin e kthen në një organ politik në varësi të KM-së.

Besa Shahini – Edhe një herë, Këshilli Kombëtar i Rinisë është organ këshillimor pranë ministrit përgjegjës për rininë, në mënyrë që të marrë mendime si nga përfaqësues të organizatave rinore dhe për të rinjtë, ashtu dhe nga institucione të tjera përgjegjëse për rininë. Kështu që ky është një organ këshillimor pranë ministrit, nuk është një këshill politik i ministrit dhe nuk e kuptoj nga vjen ky barazim i këtyre dy nocioneve.

Fatjona Dhimitri – E hedhim në votim pikën 3, sipas propozimit të Komisionit të Ligjeve. Kuptohet që u referohem ndryshimeve të bëra.

Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Në fakt, unë doja të shtoja diçka të ky nen, por nuk di a mund ta them tani që e kaluam.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Atëherë nuk po e shtoj.

Kam një njoftim për komisionin. Për shkak të angazhimeve të disa deputetëve apo organizimeve të Kuvendit, jemi të detyruar që mbledhjen e ditës së sotme ta ndërpresim këtu.

Do të njoftoheni sërish për orën e mbledhjes së radhës.

E hedhim në votim nenin 9 në tërësi, edhe pse po nxitojmë për shkak të angazhimeve.

Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Milva Ekonomi – A mund të bëj një propozim, që duhet ta diskutojmë me komisionin? A mund ta vazhdojmë mbledhjen sot, pasi të mbarojë aktiviteti që është lart, apo ta lëmë për nesër?

Fatjona Dhimitri – Unë si deputete kam angazhime të tjera, kështu që mbase është më mirë ta lëmë nesër në orën 11:00.

Milva Ekonomi – Si të doni, ose pasi të mbarojmë mbledhjen lart, zbresim poshtë.

Fatjona Dhimitri – Nuk mendoj se kjo do t'u prishë shumë punë të gjitha palëve.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Unë nuk mund të anulohet takimet e mia.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Atëherë, e lëmë si ta vendosë shumica.

Mbyllet pika e parë e rendit të ditës



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

PROCESVERBAL

Tiranë, më 14.10.2018, ora 12.00

Drejton mbledhjen:

Fatjona Dhimitri – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

2. Shpallja e 3 vendeve vakante në AMA.

Marrin pjesë:

Fatjona Dhimitri, Milva Ekonomi, Ramazan Gjuzi, Ismet Beqiraj, Fadil Nasufi, Almira Xhambulla, Bujar Çela, Lindita Nikolla, Klajdi Qama, Kostaq Papa, Selami Jenishehri, Amra Barova dhe Sadi Vorpsi (zëvendësues)

Mungojnë:

Fidel Ylli, Musa Ulqini, Vilma Bello, Adelina Rista, Mirela Kumbaro, Enada Kapllani.

Vijon pika e dytë e rendit të ditës

Milva Ekonomi – Nga ana tjetër, duhet të miratojmë kandidaturat e AMA-s. A jeni dakord të shpallim kandidaturat e AMA-s?

Fatjona Dhimitri – A ka ardhur këshilltari?

Milva Ekonomi – Ja ku është këshilltari.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Hapet vakanca dhe postohet në faqen e zyrtare.

Fatjona Dhimitri – Informacion për përfundimin e mandatit të kryetarit të Autoritetit të Medieve Audiovizive.

“Kuvendi i Shqipërisë me vendimin nr. 94/2014, datë 06.11.2014 “Për zgjedhjen e kryetarit të Autoritetit të Medieve Audiovizive” ka zgjedhur zotin Gentian Sala, bazuar në nenin 9, pika 1 e ligjit nr. 97/2013 “Për mediet audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”, i cili thotë se anëtarët e AMA-s zgjidhen nga Kuvendi për një periudhë 5-vjeçare, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë. Zotit Gentian Sala i mbaron mandati 5-vjeçar në datë 06.11.2019.

Sa më sipër, bazuar në neni 10, pika 2 e ligjit nr. 97/2013 “Për mediet audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”, jo më vonë se 30 ditë para datës së mbarimit të mandatit të kryetarit të AMA-s, Kuvendi i Shqipërisë publikon shpalljen për vendin vakant të kryetarit të AMA-s”.

Bashkëlidhur keni edhe bazën ligjore të vendimit.

Gjithashtu “Kuvendi i Shqipërisë me vendimin nr. 75/2014, datë 09.10.2014 “Për zgjedhjen e një anëtari të Autoritetit të Medieve Audiovizive” ka zgjedhur zotin Piro Misha anëtar të Autoritetit të Medieve Audiovizive. Kuvendi i Shqipërisë me vendimin nr. 74/2014 datë 09.10.2014 “Për zgjedhjen e një anëtari të Autoritetit të Medieve Audiovizive” ka zgjedhur zotin Gledis Gjipali anëtar të Autoritetit të Medieve Audiovizive.

Bazuar në nenin 9, pika 1 të ligjit nr. 97/2013 “Për mediet audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”, i cili thotë: “Anëtarët e AMA-s zgjidhen nga Kuvendi për një periudhë 5-vjeçare, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë, dy anëtarëve të sipërpërmendur, përkatësisht zotërinjve Piro Misha dhe Gledis Gjipali, u mbaron mandati 5-vjeçar në datën 09.10.2019. Sa më sipër, bazuar në neni 9, pika 2 të ligjit nr. 97/2013 “Për mediet audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”, Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Formimit

Publik, brenda 30 ditëve nga krijimi i një vendi vakant, fton, me anë të mjeteve të informimit publik, për paraqitjen e kandidaturave, subjektet përkatëse””.

Faleminderit!

Mbledhja mbyllet.

Ditën e mirë!

MBYLLET MBLEDHJA

